

VENDIM
Nr. 96, datë 9.2.2022

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I PARKIMIT PUBLIK, LULISHTE E NDRIÇIM”, BASHKIA CËRRIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i parkimit publik, lulishte e ndriçim”, Bashkia Cërrik.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Cërrik.
 3. Pronarët kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “tokë truall” dhe “ndërtesë”, me vlerë të përgjithshme prej 1 883 925 (një milion e tetëqind e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e njëzet e pesë) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 883 925 (një milion e tetëqind e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e njëzet e pesë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Cërrik.
 5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Bashkia Cërrik.
 6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është 3 (tre) muaj nga data e hyrjes në fuqi të tij.
 7. Pronarët e përmendur në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Cërrik.
 8. Bashkia Cërrik kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
 9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Cërrik.
 10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe bën kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Bashkisë Cërrik.
 11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin, kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësive në favor të Bashkisë Cërrik për pasuritë e shpronësuar.
 12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Cërrik, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “NDËRTIMI I PARKIMIT PUBLIK, LULISHTE E NDRIÇIM”, BASHKIA ÇËRRIK

NR.	EMËR ATËSI MBIEMËR	ZK	Nr. pas.	Sip. e përgj. truall (m²)	Sip. e prekur truall (m²)	Çmimi për truall	Vlera truall i prekur (lek)	Sip. e gjurmës së objektit, sipas kartelës (m²)	Sip. e përgj. ndërtimi e objektit, sipas kartelës	Sip. shërbimi (m²)	Vlera e sip. prekur, objekt shërbimi me situacion (lek)	Vlera e përgj. truall + objekt (lek)	Konfirmim ASHK Elbasan
1	Tajar Kudret Pëllumbi	1389	2/39/4	135	135	419	56,565	45	45	45	916,292	972,857	Konfirmohet me shkresën nr. 3867/1 prot., datë 8.7.2021, të ASHK Elbasan
2	Sali Ismail Braho	1389	2/93	36	36	419	15,084	36	36	36	529,835	544,919	Konfirmohet me shkresën nr. 3867/1 prot., datë 8.7.2021 të ASHK Elbasan
3	Hajrie Sherif Qevani	1389	2/94-Nd	0	0	0	0	22.7	22.7	22.7	337,615	337,615	Konfirmohet me shkresën nr. 3867/1 prot., datë 8.7.2021 të ASHK Elbasan
	Hajrie Sherif Qevani	1389	2/221	68.1	68.1	419	28,534	0	0	0	0	28,534	Konfirmohet me shkresën nr. 3867/1 prot., datë 8.7.2021 të ASHK Elbasan
VLERA TOTALE PARAPRAKE E SHPRONËSIMIT												1,883,925	